



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-06

**Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit, dhe Jakup Krasniqit**

**Vendosi:** Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 18 tetor 2021

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Tetë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Paraqitjen e Parashtrimeve**

---

**Prokurorit të Specializuar**  
Xhek Smith

**Mbrojtësit të Viktimave**  
Sajmon Loz

**Mbrojtësit të Hashim Thaçit**  
Gregori Kihou

**Mbrojtësit të Kadri Veselit**  
Ben Emerson

**Mbrojtësit të Rexhep Selimit**  
Dejvid Jang

**Mbrojtëses së Jakup Krasniqit**  
Venkatesvari Alagendra

**GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE**,<sup>1</sup> në pajtim me nenin 39(13) të Ligjit nr. 05/L053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 96(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara (“Rregullorja”), nxjerr këtë urdhër.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 26 tetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit, dhe Jakup Krasniqit (bashkërisht, “Mbrojtja”).<sup>2</sup>
2. Më 12 mars 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi “Vendim mbi Kategorizimin e Provave sipas Rregullës 109(c) dhe Çështje të lidhura me Të”, ku u urdhërua kategorizimi i materialit të rregullës 102(1)(b) sipas rrethanave të çështjes dhe afati për dorëzimin e atij materiali u shty deri më 23 korrik 2021.<sup>3</sup>
3. Më 24 qershor 2021, në bazë të kërkesës së ZPS-së,<sup>4</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake shtyu afatet në lidhje me materialin e rregullës 102(3).<sup>5</sup>
4. Më 21 korrik 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake shtyu afatin për dorëzimin e materialit të rregullës 102(1)(b) deri më 27 shtator 2021.<sup>6</sup>

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-06, F00026/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, publik; KSC-BC-2020-06, F00045/A03, Prokurori i Specializuar, *Aktakuzë e Redaktuar më tej*, 4 nëntor 2020, publike.

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-06, F00218, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kategorizimin e Provave sipas Rregullës 109(c) dhe Çështje të lidhura me Të*, 12 mars 2021, publik, para. 22.

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-06, F00356, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Zgjatjen e Afatit për Dhënien e Njoftimit sipas Rregullës 102(3)*, 18 qershor 2021, publike.

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-06, F00370, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Zgjatjen e Afatit për Dhënien e Njoftimit sipas Rregullës 102(3)*, 24 qershor 2021, publik, para. 16.

<sup>6</sup> KSC-BC-2020-06, Transkript i seancës, 21 korrik 2021, publik, f. 536, rreshtat 4-9.

5. Më 8 shtator 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori vendimin për ndryshimin e procedurës në lidhje me nxjerrjen e materialit të rregullës 102(3).<sup>7</sup>
6. Më 14 shtator 2021, në pajtim me urdhrin për caktimin e datës të Gjykatësit të Procedurës Paraprake,<sup>8</sup> u mbajt konferenca e shtatë mbi ecurinë e çështjes (“Konferenca e Shtatë mbi Ecurinë e Çështjes”).<sup>9</sup>
7. Më 24, 28, dhe 30 shtator 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miratoi disa kërkesa për zgjatjen e afatit lidhur me nxjerrjen e materialit sipas rregullës 102(3).<sup>10</sup>
8. Më 8 dhe 12 tetor 2021, Mbrojtja e Veselit dhe ZPS-ja parashtruan përkatësisht parashtrimet e tyre lidhur me datën e dorëzimit të dosjes paraprake të ZPS-së.<sup>11</sup>

---

<sup>7</sup> KSC-BC-2020-06, F00460, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Ndryshimin e Njoftimit sipas Rregullës 102(3)*, 8 shtator 2021, publik.

<sup>8</sup> KSC-BC-2020-06, F00461, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Shtatë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Paraqitjen e Parashtrimeve*, 8 shtator 2021, publik.

<sup>9</sup> KSC-BC-2020-06, Transkript i seancës, 14 shtator 2021, publik. Janë mbajtur gjashtë konferenca mbi ecurinë e çështjes para saj në intervale të rregullta, konkretisht më 18 nëntor 2020, 17 dhjetor 2020, 16 shkurt 2021, 24 mars 2021, 19 maj dhe 21 korrik 2021. *Shih* KSC-BC-2020-06, F00074, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër i Caktimit të Datës për Mbajtjen e Konferencës mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Paraqitjen e Parashtrimeve*, 11 nëntor 2020, publik, me Shtojcën 1, publike; Transkript i seancës, 18 nëntor 2020, publik; F00130, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Dytë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Paraqitjen e Parashtrimeve*, 8 dhjetor 2020, publik; Transkript i seancës, 17 dhjetor 2020, publik; F00185, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Tretë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Paraqitjen e Parashtrimeve*, 3 shkurt 2021, publik; F00193, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Ndryshimin e Datës së Konferencës së Tretë mbi Ecurinë e Çështjes*, 9 shkurt 2021, publik; Transkript i seancës, 16 shkurt 2021, publik; F00227, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Katërt mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Paraqitjen e Parashtrimeve*, 17 mars 2021, publik; Transkript i seancës, 24 mars 2021, publik; F00300, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Pestë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Paraqitjen e Parashtrimeve*, 14 maj 2021, publik, para. 19; Transkript i seancës, 19 maj 2021, publik; F00393, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Gjashtë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Paraqitjen e Parashtrimeve*, 12 korrik 2021, publik, para. 15; Transkript i seancës, 21 korrik 2021, publik.

<sup>9</sup> KSC-BC-2020-06, F00460, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Ndryshimin e Njoftimit sipas Rregullës 102(3)*, 8 shtator 2021, publik.

<sup>10</sup> KSC-BC-2020-06, F00487, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Zgjatjen e Afatit*, 24 shtator 2021, publik, para. 14; F00496, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Zgjatjen e Afatit*, 28 shtator 2021, para. 14; F00489, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Zgjatjen e Afatit*, 30 shtator 2021, para. 14.

<sup>11</sup> KSC-BC-2020-06, F00510, Mbrojtja e Veselit, *Kërkesë e Mbrojtjes së Veselit për një Afat për Dosjen Paraprake të ZPS-së*, 8 tetor 2021, publike; F00520, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë lidhur me Datën e Dorëzimit të Dosjes Paraprake*, 12 tetor 2021, publik.

9. Më 18 tetor 2021, pas një kërkesë të ZPS-së,<sup>12</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake pezulloi afatet e ZPS-së lidhur me materialin sipas rregullës 102(3) dhe urdhëroi Mbrojtjen dhe mbrojtësin e viktimave të bënin parashtrimet e tyre lidhur me kërkesën e ZPS-së, nëse dëshironin, për konferencën e radhës të ecurisë së çështjes.<sup>13</sup>

## II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

10. Në pajtim me rregullën 96(1) të Rregullores, pas konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbledh konferenca pasuese mbi ecurinë e çështjes, nëse konsiderohet e nevojshme për: (i) organizimin e shkëmbimeve midis palëve dhe, kur është e zbatueshme, mbrojtësit të viktimave, për të mundësuar përgatitje të shpejtë për gjykim; (ii) ndërmarrjen e hapave që mundësojnë çdo përgatitje të nevojshme prej palëve në mënyrë të zellshme dhe në kohë; dhe (iii) rishikimin e ecurisë së çështjes gjyqësore dhe që palëve, e kur është e zbatueshme mbrojtësit të viktimave, t'u jepet mundësia e ngritjes së problemeve në lidhje me çështjen gjyqësore.

11. Në pajtim me nenin 21(6) të Ligjit, i gjithë materiali dhe provat ose faktet relevante në zotërim të ZPS-së të cilat janë në favor ose kundër të akuzuarit, i vihen në dispozicion të akuzuarit para fillimit të procesit dhe gjatë procesit, vetëm me kufizimet rreptësisht të domosdoshme dhe me zbatimin e masave mbrojtëse kompensuese të nevojshme. Në pajtim me rregullën 102(3) të Rregullores, ZPS-ja i jep njoftim të hollësishëm Mbrojtjes për çdo material dhe provë që ka në zotërim.

---

<sup>12</sup> KSC-BC-2020-06, F00527, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Zgjatje Afati*, 14 tetor 2021, publike.

<sup>13</sup> KSC-BC-2020-06, F00528, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër në lidhje me Kërkesën e Prokurorisë për Zgjatje Afati*, 18 tetor 2021, publik.

12. Në pajtim me rregullën 95(4) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron ZPS-në që brenda një afati të përcaktuar, të dorëzojë: (i) dosjen paraprake, ku përfshihet çdo pranim në lidhje me faktet nga ana e Mbrojtjes dhe një listë e pikave të pakontestuara; (ii) listën e dëshmitarëve që synon të thërrasë; dhe (iii) listën e provave materiale që synon të paraqesë, ku përfshihet, kurdo që është e mundshme, çfarëdo kundërshtimi i Mbrojtjes lidhur me autenticitetin e tyre.

13. Në pajtim me rregullën 95(5) të Rregullores, pas dorëzimit të materialeve të përmendura në rregullën 95(4) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake fton Mbrojtjen që brenda një afati të përcaktuar të dorëzojë dosjen e vet paraprake. Gjithashtu, brenda afatit të përcaktuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Mbrojtja informon ZPS-në mbi synimin e vet për të përdorur alibinë ose çfarëdo arsye tjetër që përjashton përgjegjësi penale, ndër të cilat aftësia mendore e kufizuar ose mungesa e aftësisë mendore, intoksikimi, domosdoshmëria, shtrëngimi dhe gabime faktike ose ligjore.

14. Në pajtim me rregullën 96(2) të Rregullores, me pëlqimin me shkrim të të akuzuarit që jepet pas këshillimit me mbrojtësin, konferenca mbi ecurinë e çështjes mund të mbahet: (i) në praninë e të akuzuarit dhe me pjesëmarrjen e mbrojtësit nëpërmjet videokonferencës; (ii) në praninë e mbrojtësit dhe me pjesëmarrjen e të akuzuarit nëpërmjet videokonferencës; ose (iii) në mungesë të të akuzuarit me praninë e mbrojtësit, ose me pjesëmarrjen e mbrojtësit nëpërmjet videokonferencës. Gjithashtu, çdo kërkesë për pjesëmarrje në konferencën mbi ecurinë e çështjes nëpërmjet videokonferencës i bëhet drejtpërdrejt Administratores, në pajtim me Udhëzuesin e Punës të Administratores për Videolidhjet (KSC-BD-23/COR),

paraprkisht e në kohë të mjaftueshme, në mënyrë që Administratorja të ndërmarrë hapat e duhur, përfshirë informimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake.<sup>14</sup>

### III. DISKUTIM

15. Pasi ka shqyrtuar preferencat për datat të shprehura nga palët dhe mbrojtësi i viktimave si edhe disponueshmërinë e sallës së gjyqit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake cakton që konferenca e tetë mbi ecurinë e çështjes të mbahet të premtën, më 29 tetor 2021, në orën 14:30.

16. Gjatë seancës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do t'u kërkojë palëve përditësime, nëse kanë, për pikat ende të pazgjidhura nga konferenca e shtatë mbi ecurinë e çështjes, dhe për parashtrimet me shkrim dhe me gojë që kanë bërë në lidhje me ato pika. Konkretisht dhe gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të kërkojë përditësime në lidhje me pikat në vijim, sipas radhës së përcaktuar më poshtë:

(1) Nxjerrja e materialeve:

- a. Nëse ZPS-ja është afër përfundimit të procedurës së nxjerrjes së materialit të rregullës 102(1)(b) (në përjashtim të materialit në pritje të kërkesave për masa mbrojtëse) dhe nëse përkthimet e këtyre materialeve do të përfundojnë të shpejti;
- b. nëse palët mund të japin përditësime se sa kanë përparuar drejt përfundimit të procedurës për nxjerrjen e materialit të rregullës 102(3), në veçanti Kërkesën e ZPS-së për ndryshimin e afateve të zbatueshme për (i) kërkesën sipas

---

<sup>14</sup> *Shih gjithashtu KSC-BC-2020-06, F00062, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Vendim për Autorizim të Pjesëmarrjes përmes Videolidhjes, 6 nëntor 2020, publik, para. 10; F00069, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Vendim për Autorizim të Pjesëmarrjes përmes Videolidhjes, 9 nëntor 2020, publik, para. 9.*

rregullës 102(3) të parashtruar nga Jakup Krasniqi dhe (ii) çdo kërkesë sipas rregullës 102(3) në të ardhmen deri në tri javë për kundërshtim të materialitetit dhe gjashtë javë për nxjerrjen e materialeve dhe/ose masat mbrojtëse;

- c. nëse ka ende prova shfajësuese në ruajtjen, kontrollin apo dijeninë faktike të ZPS-së, të cilat duhet t'i nxirren Mbrojtjes në pajtim me rregullën 103 të Rregullores, dhe nëse pritet të bëhet ndonjë kërkesë për masa mbrojtëse në lidhje me to; dhe
- d. nëse është bërë përparim në procesin e nxjerrjes së materialeve sa i përket materialit të rregullës 107, dhe nëse pritet të bëhen kërkesa të tjera sipas kësaj rregulle

(2) Përkthimet:

- a. çfarë përparimi ka bërë Njësia e Përkthimit lidhur me përkthimin e vendimeve dhe mocioneve paraprake; dhe
- b. nëse palët kanë parashtruar kërkesa të tjera urgjente për përkthim.

(3) Hetimet e ZPS-së dhe hapat e mëtejshëm:

- a. nëse ZPS-ja mund të japë një vlerësim të mëtejshëm në lidhje me datën e parashikuar për përfundimin e hapave hetimorë të papërfunduar; dhe
- b. nëse ka ndonjë problem të parashikuar me afat deri më 17 dhjetor 2021 të përcaktuar për parashtrimin e dosjes paraprake të ZPS-së dhe materialit të lidhur me të sipas rregullës 95(4)(a)-(c) të Rregullores.
- c. nëse ka ndonjë problem të parashikuar me zgjatjen e afatit të ZPS-së për parashtrimin e tabelës sipas rregullës 109(c) deri më 28 janar 2022, ose, nëse afati për dorëzimin e dosjes paraprake të ZPS-së përcaktohet për një datë



tjetër, 30 ditë nga ajo datë për parashtrimin e tabelës sipas rregullës 109(c), dhe

- d. nëse ka ndonjë problem lidhur me dorëzimin e listës paraprake të dëshmitarëve nga ZPS-ja më 22 tetor 2021.

(4) Hetimet e Mbrojtjes dhe hapat e mëtejshëm:

- a. nëse Mbrojtja mund të japë më shumë informacion për ecurinë e hetimeve të saj;
- b. po ashtu, nëse Mbrojtja mund të japë më shumë informacion për synimin e vet për të bërë kërkesa në lidhje me mundësitë hetimore unike, në pajtim me rregullën 99(1) të Rregullores; dhe
- c. nëse Mbrojtja mund të japë më shumë informacion për synimin e vet për të dhënë njoftim për alibi ose arsye që përjashtojnë përgjegjësi penale në pajtim me rregullën 95(5) të Rregullores, dhe për nxjerrjen e materialeve përkatëse, në pajtim me rregullën 104(1) dhe (2) të Rregullores

17. Palët dhe pjesëmarrësit ftohen të paraqesin parashtrime me shkrim, nëse dëshirojnë, për cilëndo nga pikat e lartpërmendura. Në rast se palët ose pjesëmarrësit dëshirojnë të ngrenë çështje të tjera gjatë konferencës së ardhshme mbi ecurinë e çështjes, të cilat nuk janë përfshirë në këtë urdhër, ftohen t'i përfshijnë ato në parashtrimet e tyre me shkrim. Palët dhe pjesëmarrësit ftohen që t'i paraqesin këto parashtrime deri në mesditën e së mërkurës, 27 tetor 2021.

#### IV. VENDIM

18. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:



